

VENDIM
Nr. 48, datë 29.4.2016

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIM E SHOQËRISË “XHENGO
ENERGJI” SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE
NGA HEC “KASOLLET E SELCËS”**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a” dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a”; 10, pika 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.4.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Xhengo Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin e kësaj shoqërie në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kasollet e Selcës”,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Xhengo Energji” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3, gjerat “a”, “b” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5, gjerat “a” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Dokumentet që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit (neni 9, pika 3, germa “c”);
- Lejen e përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike (neni 9, pika 4.1.5, germa “b”), do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Xhengo Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i “Kasollet e Selcës”, me fuqi të instaluar 4000 kw.

2. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti